Për: z.Zenun Elezaj, kryetar i komunës Klinë

z.Lorenc Marleku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Klinë

Nga: z.Arianit Thaqi, menaxher i kontratës

Lënda: **Raport mbi përfundimin e punimeve të projektit "Ndërtimi i Kanalizimit në Qupevë të Ulët"**

Data: 13.05.2019

Të nderuar,

Lidhur me kontratën "Ndërtimi i kanalizimit në Qupevë të Ulët" me nr 01nr 352-13677/19 të datës 05.04.2019 më lejoni të ju njoftoj se Operatori Ekonomik "Construction –Group-SHPK" (në vazhdim OE) ka filluar punimet me datë 10.04.2019 dhe gjatë vizitave është vërejtur që ka respektuar rregullat teknike për punishtë, projektin dhe pozicionet në paramasë. Punimet janë të evidentuara në ditarin e ndërtimit dhe librin e ndërtimit.

OE me datë 04.05.2019 ka përfunduar të gjitha punimet ndërsa vizita e fundit mbikqyrëse është kryer me datë 06.05.2019 (ditë e hënë).

OE me rastin e përfundimit të punimeve ka dorëzuar:

-ditarin e ndërtimit

-librin e ndërtimit

-ateste të nevojshme

Afati kohor për kryerjen e punimeve ka qenë 40 ditë pune, ndërsa punimet kanë përfunduar për 20-21 ditë pune.

Duke respektuar procedurat është formuar komisioni për pranim teknik, komision i cili ka dalë në terren dhe më pas ka shqyrtuar dokumentacionin teknik.

Të bashkangjitur gjeni fotografi të punimeve, procesverbalin e pranimit teknik dhe situacionin e rrjetit të kanalizimit.

| | |
|---|---|
| Përgatiti: | Pranoi: |
| Menaxher i kontrates | Menaxher i projektit |
| Arianit Thaqi | Lorenc Marleku |
| ____________ | ________________ |

# PROCESVERBAL

**I pranimit teknik te perkohshem te punëve ne projektin "Ndertimi i i kanalizimit ne Qupevë te Ulet " Komuna e Klinës**

**Klinë: 10.05.2019**

I përpiluar me datën,10.05.2019 nga ana e komisionit për pranim teknik te punëve në projektin **"Ndertimi i kanalizimit ne Qupevë te Ulet" Komuna e Klinës**
Komisioni është formuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit me Vendim 06 nr351- 18387/19 te datës 10.05.2019 me ketë përbërje

1. Antonije Selmani -. kryetar
2. Dardan Bashota –antar
3. Ali Gashi – antar

Komisioni me përbërje te plotë ka filluar me punë me 10.05.2019 ne ora 11, ku te pranishëm ishin menaxheri i kontrates si dhe perfaqesuesi i punëkryesit.
Detyrë e komisionit për kontrolle teknik është shqyrtimi i dokumentacionit investivo teknik ne bazë te se cilit është ndërtuar objekti dhe shikimi i punëve te kryera ne vend.
Ne bazë te shikimit te dokumentacionit investivo teknik komisioni ka konstatuar :

## I Te dhënat e përgjithshme

- **investitor Komuna e Klines**
- **punekryes OE" Construksion Group "shpk nga Prishtina.**
- **kontrata ne mes te Komunës se Klinës dhe OE "Construcsion Group" shpk nga Prishtina nr.14/2019 me numer protokoli 01nr.352-13677/19 e datës 05.04.2019 me vlerë 19432,77€**
- **Vendimi per menaxhimin e kontrates 01nr.352-13677/19 te dates 05.04.2019**
- **Vendimi i komisionit për pranim teknik 06nr.351-18387/2019 te dates 10.05.2019**
- **Planin dinamik 40 ditë**

## II Kontrolli i dokumentacionit teknik

- Projekti me paramasë dhe parallogari
- Paramasa e puneve te realizuara
- Ditarin ndërtimor
- Libri ndërtimor
- Fotografit e realizuara gjatë punimeve

## III Kontrolli i punëve te kryera ne vend

Pas shikimit te dokumentacionit investivo -teknik ,anëtaret e komisionit ne pranin e përfaqësuesit te ekzekutimit te punimeve, menaxherit te projektit dhe organit mbikëqyrës benë shikimin ne vend me qellim te kontrollit te kualitetit te punëve te kryera,veçanërisht ne aspektin e plotësimit te kërkesave themelore për ndërtim dhe me ketë rast konstatoi:

- Ndertimi i kanalizimit ne Qupevë te Ulet komuna e Klines është ndërtuar sipas kontratës dhe parakushteve te ofruara nga projekti

Andaj pas shqyrtimit te dokumentacionit tekniko investiv qe pati ne dispozicion komisioni, dhe pas shikimit te punëve ne vend, bazuar ne konstatimet e lartcekura jep ketë

**PERFUNDIM**

Ndertimi i kanalizimit ne Qupevë te Ulet Komuna e Klines është ndërtuar ne pajtim me dokumentacionin teknik dhe projektin . Gjatë ndërtimit janë aplikuar normativat dhe standardet e kërkuara për ketë lloji ndërtimi. Andaj behet pranimi teknik i perkohshem deri ne kalimin e afatit garantues ku do te behet dhe pranimi perfundimtar.
Komisioni përfundoj me punë ne ora 15,00h.

**Menaxheri i projektit**

**Lorenc Marleku**________

**Menaxheri i kontrates**

**Arianit Thaqi**______________

**Komisioni për pranim teknik:**

1. **Antonije Selmani** ______
2. **Dardan Bashota** ______
3. **Ali Gashi** ______



















Ndërmarrja Projektuese

**Art Project**

Klinë
044/318-571

| | |
|---|---|
| Investitori: | KK KLINE |
| Projekti kryesor: | **KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA** |
| Vendi: | QUPEVE E ULET |
| Projektoi: | Idn Anita Kabashi |
| Data: | Shtator 2017 |
| Përmbajtja: | **SITUACIONI** |
| Perpjesa: | Nr. i fletes |
| P=1:1500 | 01 |